



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1870, datë 10.04.2012**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”,**

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”;
- Shkresa e Nisatel sh.p.k., nr. 100/1Prot., e datës 3.1.2012, “*Mbi Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1731, datë 20.12.2011*”;
- Shkresa e AMC me 4963/3 Prot., datë 4.1.2012 (nr. 1690Prot. i AKEP, datë 4.1.2012) “*Pretendimet e AMC për ankimin administrativ kundër Nisatel sh.p.k.*”.

diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
  - “*Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.*”;
  - *Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.*” për fillimin e procedimit administrativ;

- *Palët të depozitajnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit*”;

II. Nisatel sh.p.k. me shkresën nr. 100/1Prot., datë 3.1.2012, “*Mbi Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1731, datë 20.12.2011*”, ka paraqitur pretendimet si më poshtë:

1. Nisatel sh.p.k. është njoftuar nga AMC sh.a. për fillimin e shërbimit të ri të telefonisë fikse “AMC FIX”. Nisatel sh.p.k. me shkresën e datës 19.6.2011, dhe email datë 27.10.2011, njofton AMC se në lidhje me implementimin e shërbimit të ri të AMC, dhe amendumit të propozuar nevojitet që së pari sipërmarrësit të bien dakord për anën teknike dhe financiare. Nisatel sh.p.k., ka propozuar tarifë terminimi 3.7 lekë/min, si tarifë brenda kufijve të përcaktuar nga rregullatori dhe e zbatuar nga të gjithë me të gjithë sipërmarrësit e shërbimit të telefonisë fikse në marrëveshjet e asaj periudhe.
2. Nisatel sh.p.k. nuk ka patur kapacitete transmetimi nga Vlora (qendra kryesore e komutimit) - në Tiranë (pop i Nisatel i tranzitimit) deri më datë 13.12.2011, për këtë arsye i ka propozuar AMC interkoneksion direkt në pikën e lidhjes Vlorë. Ndërkohë Nisatel sh.p.k. ka filluar punimet për të rritur kapacitetin e transmetimit VL-TR dhe të përshtasë konfigurimet në rrjetin e tij për t’u përgjigjur kërkesave të OFNT dhe brezit të shërbimeve që ata ofrojnë.
3. Nisatel sh.p.k. në funksion të menaxhimit korrekt të thirrjeve me topologji të ndryshme që terminohen në rrjetin e tij nga operatorë mobile ka riorganizuar teknikisht interkoneksionin që nga dita që AMC ka shprehur kërkesën deri në datën 10.12.2011, rrugëzimin e thirrjeve në pikat lokale / kombëtare / ndërkombëtare të interkoneksionit.
4. Nisatel ka njoftuar AMC me shkresën nr. 488/4Prot., datë 13.12.2011, “Mbi rugëzimin e trafikut të terminuar në rrjetin e Nisatel” ku njofton se ka përfunduar:
  - a) zgjerimin e kapaciteteve teknike duke riformatuar topologjinë e rrjetit të vet në funksion të kërkesave të operatorëve për interkoneksion, duke krijuar dy pika kombëtare dhe një pikë ndërkombëtare interkoneksioni.
  - b) shpalljen e tarifave për terminimin e trafikut sipas natyrës dhe në funksion të pikës së interkoneksionit:
    - *Segment njëfish*: 1.95 lekë/min + 0.83 lekë/thirrje – trafik i gjeneruar në rrjetin kombëtar dhe i dorëzuar nga operatorët mobil në pikën lokale të interkoneksionit dhe i përcjellë nga Nisatel tek abonenti fundor i tij.
    - *Segment dyfish*: 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje – trafik i gjeneruar në rrjetin kombëtar dhe i dorëzuar nga operatorët mobil në pikën kombëtare të interkoneksionit dhe i përcjellë nga Nisatel tek abonenti fundor i tij.
    - *Segment dyfish*: 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje – trafik i gjeneruar nga operatorët ndërkombëtar dhe i terminuar nga operatorët mobil në pikën ndërkombëtare të interkoneksionit të Nisatel.

5. Nisatel sh.p.k. nuk e ka pranuar tarifën ekzistuese të terminimit të thirrjeve prej 1.5 lekë/min nga AMC, por është gjendur në presion për të firmosur MI dhe i kërcënuar për ndërprerje të njëanshme të interkoneksionit. Ky presion vazhdon edhe pasi Nisatel sh.p.k. ka njoftuar prej disa muajsh AMC për implementimin shërbimin e terminimit të thirrjeve me bartje (tranzitim) për operatorët alternative të cilët kërkojnë të terminojnë nëpërmjet (tranzitimit të )Nisatel thirrjet e tyre drejt AMC. Ky shërbim është i përfshirë në MI ekzistuese të firmosur nga palët, por AMC e ka pezulluar dhe nuk e zbaton, duke ushtruar presion mbi Nisatel dhe duke e detyruar të nënshkruajë amendumin e telefonisë fikse sipas kushteve të saj jashtë normave të rregullatorit. Aktualisht, janë në pritje të këtij shërbimi sipërmarrësit: Levendi, Bitri, Lem, Fjoart dhe Tele&Co.

III. AMC me shkresën nr. 4963/3, datë 4.1.2012, “*Pretendimet për ankimin administrativ kundër Nisatel sh.p.k.*”, ka paraqitur pretendimet si më poshtë:

1. AMC pas marrjes së Autorizimit të Përgjithshëm dhe Autorizimit Individual, të lëshuara nga AKEP, në përputhje me ligjin nr. 9918, ka kërkuar akses dhe interkoneksion tek të gjithë operatorët alternativë dhe mobile në mënyrë që shërbimi i ri t’i ofrohej publikut sa më shpejt të ishte e mundur. Me të gjithë operatorët e tjerë të cilët janë lidhur direkt me AMC si edhe me mobilët, negociatat për interkoneksion për AMC FIX, janë kryer brenda afateve të parashikuara në ligj dhe në rregullore. Me operatorin këto negociata nuk kanë arritur të përfundojnë me lidhjen e MI, për shkaqe që burojnë nga ky operator.
2. AMC me e-mail të datës 2.6.2011, dhe më vonë me shkresën nr. 1401/3, datë 1.7.2011, ka dërguar tek Nisatel sh.p.k. kërkesë për implementimin e numeracionit fiks dhe nënshkrimin e adendumit në kontratën kryesore të interkoneksionit për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse nga ana e AMC. Në këtë shkresë AMC njoftonte tarifë terminimi në rrjetin e saj fiks prej 1.5 lekë/min, sic e kishte njoftuar tek të gjithë operatorët e tjerë alternativë. Operatorët e tjerë alternativë kanë në të njëjtën kohë tarifë terminimi 1.5 lekë për AMC, e cila është e njëjtë si për trafikun e origjinuar nga rrjeti mobile i AMC, ashtu edhe për atë që do të origjinohet nga rrjeti fiks i saj.
3. Në këtë proces përjashtim bën vetëm Abcom sh.p.k. i cili tarifon AMC si për mobile ashtu edhe për fiks me 2.5 lekë/min. Në të njëjtën kohë AMC e tarifon Abcom me të njëjtën tarifë prej 2.5 lekë/min për terminim në rrjetin fiks të AMC. Sa më sipër, është ruajtur dhe aplikuar parimi i simetrisë së plotë për terminim në rrjetat fikse të AMC dhe operatorëve alternativë.
4. Nisatel më datë 19.7.2011, dërgon përgjigje ku kërkohet tarifë terminimi 3.7 lekë/min për trafikun e origjinuar nga rrjeti fiks i AMC, ndërkohë që në kontratën e kryesore të interkoneksionit midis AMC dhe Nisatel tarifa e terminimit për trafikun e origjinuar nga rrjeti mobil i AMC është 1.5 lekë/min.
5. AMC i ka kthyer përgjigje me e-mail, Nisatel më datë 17.8.2011, se Nisatel nuk mund të paraqiste një tarifë terminimi për 3.7 lekë/min për trafikun e origjinuar

nga AMC FIX e cila është e ndryshme nga tarifa e terminimit për trafikun e origjinuar nga rrjeti mobile. Bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, i cili është i njëjtë për të gjithë operatorët, nuk ka diskriminim sa i përket origjinimit të trafikut për tarifën e terminimit. Nëse për terminimin në rrjetet e lëvizshme tarifa e terminimit është 1.5 lekë/min, ajo duhet të jetë e njëjtë edhe për trafik të origjinuar nga rrjeti AMC FIX. Nisatel nuk ka hequr dorë nga pretendimi edhe pse i është shpjeguar disa herë parimi i mosdiskriminimi.

6. AMC në lidhje me çështjen e tarifave mban qëndrimin si më poshtë:

- Sa i takon tarifës terminuese në rrjetin e Nisatel, bazuar në kuadrin rregullator nuk duhet të ketë dallim sipas origjinës së thirrjes për tarifën e terminimit. Nisatel është operator i telefonisë fikse dhe si i tillë tarifa terminuese në rrjetin e tij si për trafikun e origjinuar nga numeracioni fiks i AMC ashtu edhe për trafikun origjinuar nga rrjeti mobile duhet të jetë e njëjtë 1.5 lekë/min për të gjitha llojet e thirrjeve pavarësisht origjinimit të tyre.
- Lidhur me zgjidhjen teknike, AMC mendon që trafiku i interkoneksionit nga/drejt numeracionit AMC FIX, të kalojë përmes trafikut kombëtar ekzistues. Por duke qenë se është një produkt i ri, akoma i pabalancuar në treg, për sa i takon kapaciteteve momentalisht nuk e konsideron të nevojshme. Për muajt e parë të lancimit të produktit në treg parashikohet të ketë trafik të ulët drejt rrjetit të operatorit Nisatel dhe rrjedhimisht impakti për sa i takon kapaciteteve teknike është i ulët. Edhe në këtë rast nuk ka arsye diskriminimi për origjinën e trafikut, është fiks apo mobile, ai gjenerohet nga e njëjta kompani. Prandaj nuk ka arsye që në këtë moment të lindë problemi i shtimit të kapaciteteve.
- Lidhur me garancinë financiare, në cdo rast te tejkalimit të trafikut me më shumë se 30 % për dy muaj të njëpasnjëshëm apo të rritjes së kapaciteteve ekzistuese mund të bëhet rishikim garancie.

7. Në përfundim, AMC konstaton se:

- Janë tejkaluar të gjitha afatet nga Nisatel për lidhjen e MI për të interkonektuar numeracionin fiks të AMC me rrjetin e tij fiks afat ky i përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr. 9918;
- Detyrimet që burojnë nga kuadri rregullator duhet dhe janë të njëjta për të gjithë operatorët që operojnë në treg, tarifa e terminimit e ofruar nga Nisatel për AMC fiks duhet të jetë e njëjtë për terminimin e trafikut të AMC mobil.

8. Për sa më sipër AMC i kërkon AKEP :

Të urdhërojë lidhjen e interkoneksionit dhe nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse, sipas kërimit të AMC, për mundësimin e hapjes dhe vijimin e trafikut të AMC fiks në linkun ekzistues të lidhur direkt me Nisatel, duke detyruar Nisatel të ofrojë të njëjtën tarifë terminimi për trafikun e terminuar në

rrjetin e tij, pavarësisht se nga është origjinuar trafiku, nga rrjeti fiks apo mobil i AMC.

IV. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e palëve gjykon se:

- a. Pretendimi i AMC se tarifat e terminimit në rrjetin e Nisatel nuk duhet të kenë ndryshim nëse ato janë për terminim të thirrjeve të origjinuara nga abonentët celularë apo të AMC Fix është i drejtë. Megjithatë tarifat për të dy llojet e trafikut të origjinuar nga abonentët celularë dhe AMC fix duhet të jenë në varësi të pikës së interkoneksionit ku dorëzohet ky trafik në rrjetin Nisatel. Sipas shkresave dhe pretendimeve të Nisatel, ai njofton se ka dy pika interkoneksioni për thirrjet kombëtare: një në Vlorë dhe një në Tiranë. Për trafikun që përcillet nga AMC (celular apo fiks) deri në pikën e interkoneksionit në Vlorë dhe terminohet në Vlorë, AMC duhet të paguaje tarifë terminimi në nivel lokal. Për trafikun që dorëzohet në Tiranë dhe terminohet në Vlorë AMC duhet të paguajë tarifë terminimi në segment dyfish.
- b. Nisatel pretendon se tarifa e terminimit 1.5 lek/minute për thirrjet e origjinuara nga pajtimtarët celular të AMC është pranuar nga Nisatel për shkak të presionit të AMC për shpërndarje në rast të mospranimit të kësaj tarife. Megjithëse Nisatel nuk ka bërë kërkesë për zgjidhje mos-marrvëshje për këtë ceshtje në AKEP, Nisatel ka përfshirë në pretendimet për këtë mosmarrvëshje rishikimin e kësaj tarife, për të qënë e njëjtë me tarifen e terminimit të thirrjeve të origjinuara nga AMC fiks.
- c. Nga informacioni i marrë nga operatorët rezulton se Nisatel interkonektohet me AMC në Tiranë në centralin MSC të AMC duke përdorur linke-t e veta dhe të marra nga operatorë të tjerë për të lidhur centralin e vet në Vlorë me pikën e interkoneksionit të AMC.
- d. Nisatel ka lidhur MI me Albtelecom duke rënë dakort që tarifat e terminimit në rrjetin Nisatel të jenë 1.95 lek/minute për segment lokal dhe 3.25 lek/minute për segment njëfish (rajonal), përfshirë 0.83 lek/thirrje për të dy segmentet.
- e. AKEP me VKD nr. Nr.1681, datë 08.09.2011, ka arsyetuar që tarifa e terminimit në rrjetin Abcom të jetë 2.5 lek/minute (pa TVSH), duke marrë në konsideratë faktin që Abcom është një ndër operatorët alternativë fiks që ka kryer investime të konsiderueshme në rrjet për linjat e aboneteve fundorë si dhe tarifa 2.5 lek/minute (që është edhe si vlerë mesatare e tarifave të terminimit në rrjetin Abcom për thirrjet e përcjella nga Albtelecom: 1.95 dhe 3.25 lek/minute).
- f. Mosmarrvëshja AMC Fiks v Nisatel ka ngjashmëri me rastin e mosmarrvëshjes Vodafone v Abcom, për terminimin e thirrjeve të AMC Fiks në rrjetin Nisatel, dhe Nisatel aplikon të njëjta tarifa terminimi ndaj Albtelecom si edhe Abcom. Në këtë mënyrë AKEP gjykon se për zgjidhjen e kësaj mosmarrvëshje ti referohet për analogji marrëeshjeve të AMC me Abcom, për AMC celulare dhe fiks. Në këtë mënyrë aplikimi i tarifës 2.5 lek/minute (pa TVSH) dhe pa tarifë për thirrje, për terminimin e thirrjeve të origjinuar nga AMC Fiks në rrjetin Nisatel, është tarifë e arsyshme për kushtet aktuale të tregut dhe karakteristikat e rrjetit të operatorit

Nisatel, që ka investuar në rrjet fundor në Vlorë dhe link-e transmetimi Vlorë-Tiranë. Ndërkohë, tarifa e terminimit në rrjetin AMC për AMC Fiks të jetë 2.5 lek/minutë (pa TVSH) si me Abcom. Për sa i përket tarifës së terminimit në rrjetin Nisatel për thirrjet e abonentëve celularë, duke qënë se AMC nuk i dorëzon më në lidhjen me Nisatel në Vlorë si dhe për shkak të mos-ndryshimit të tarifës së terminimit sipas origjinës (celularë apo AMC Fiks), tarifa e deritanishme 1.5 lek/minutë dhe 0.83 lek/thirrje, të bëhet 2.5 lek/minutë (pa TVSH), në nivel të njëjtë si për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga AMC Fiks.

- g. Aktualisht AMC dhe Nisatel kanë marrëveshje interkoneksioni me nr.1553 prot., datë 31.03.2011 (referenca e AMC) por që nuk përfshin terminimin e thirrjeve drejt dhe nga abonentët e AMC Fiks në rrjetet respective. AMC ka nënshkruar amendime të MI me operatorët e tjerë dhe në këtë rast, në kushtet e mungesës së një marrëveshje për terminimin e thirrjeve në rrjetet respective për AMC Fiks, vendimi i AKEP për mbylljen dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit duhet të shoqërohet me urdhër për lidhjen e MI sipas nenit 60 të ligjit 9918.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

### **V E N D O S:**

1. Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”;
2. Tarifa e terminimit në rrjetin Nisatel të thirrjeve të origjinuara nga abonentët e telefonisë celulare dhe të telefonisë fikse të AMC të jetë 2.5 lek/minutë (pa TVSH);
3. Tarifa e terminimit në rrjetin AMC të thirrjeve të abonentëve të Nisatel drejt abonentëve të telefonisë fikse të AMC të jetë 2.5 lek/minutë (pa TVSH).
4. AMC sh.a dhe Nisatel sh.p.k të lidhin Marrëveshje Interkoneksioni (MI) ose të amendojnë MI aktuale duke përfshirë shërbimet e terminimit në rrjetet respektive për thirrjet drejt dhe nga abonentët AMC Fiks, sipas Urdhërit bashkangjitur këtij Vendimi.

5. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k. për mbylljen e procedimit administrativ dhe Urdhërin për lidhjen e MI.
6. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**U R D H Ë R**

**Nr.1 , date 10.04.2012**

**Për**

**“Lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Nisatel sh.p.k.”**

Në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullore Nr.18, date 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, Rregullore Nr.19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar, VKD nr. \_\_\_\_\_, date \_\_.\_\_.2012, “Për mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Nisatel sh.p.k.””

**U R D H Ë R O J:**

1. Albanian Mobile Communications sh.a të lidhë Marrëveshje Interkoneksioni (MI) me Nisatel sh.p.k. ose Amendament të MI aktuale, për përfshirjen e shërbimeve të terminimit në rrjetet e të dy palëve për thirrjet drejt/nga abonentët e AMC Fiks si dhe të tarifave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të Vendimit, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të këtij Urdhëri.
2. Palët të depozitojnë në AKEP një kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit apo Amendamentit të nënshkruar nga palët brenda (pesë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj;
3. Moszbatimi i këtij urdhëri përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky Urdhër hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**A N Ë T A R Ë T:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE